

NJOFTIM

PËR PJESËMARRJEN NË TAKIMIN PARA-OFERTËS DHE VIZITA NË TERREN PËR PROCESIN KONKURRUES PËR PËRZGJEDHJEN E PROJEKTIT QË DO TË PËRFITOJË MASAT MBËSHTETËSE PËR NDËRTIMIN E IMPIANTIT FOTOVOLTAIK NË ZONËN E AKËRNISË (VLORË)

Bazuar në Seksionin Nr. 1, Pika 19, e Dokumenteve të Procesit Konkurrues (DPK), “Për përzgjedhjen e projektit që do të përfitojë masat mbështetëse për ndërtimin e impiantit fotovoltaik në zonën e Akërnisë (Vlorë)”, është parashikuar një takim para-ofertës dhe vizitë në terren, e cila do të zhvillohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim informimin e ofertuesve mbi disa detaje konkrete të projekt-idesë, objekt i Procesit Konkurrues në fjalë.

MIE informon të gjithë ofertuesit e mundshëm, që kanë bërë pagesën e pjesëmarrjes në Procesin Konkurrues, që takimi i para-ofertës dhe nisja për në terren do të bëhet nga MIE (godina qendrore, me adresë Rr. “Abdi Toptani”, Nr.1), në datën 27 Gusht 2018.

Nga ora 10.00 (a.m) – 10:30 (a.m) do të bëhet takimi dhe regjistrimi i pjesëmarrësve, dhe në orën 10:30 (a.m) nisja për në terren sipas përcaktimit të mëposhtëm.

Vizita parashikon një ndalesë në: Zonën e Akërnisë, Zona Kadastrale ZK.1007, Bashkia Vlorë.

Në përfundim të vizitës, pjesëmarrësit do të pajisen me një dokument pjesëmarrje.

Mjetet e transportit për vizitën në terren do të sigurohen nga vetë pjesëmarrësit.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Tiranë